



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

Nr 7205 prot.

Lezhë, më: 30.05.2025

PROJEKT-V E N D I M

NR. \_\_\_\_\_, Datë 30.05, 2025

PËR

MIRATIMIN E HAPJES SË RRUGËS SË LAGJES BUTEM DHE DHËNIEN NË  
PËRDORIM TË FONDIT PYJOR KOMBËTAR, SHOQËRISË T&J CONSTRUCTION  
SH.P.K, PËR NDËRTIMIN E RRUGËS AUTO TË LAGJES BUTEM, FSHATI  
UNGREJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE UNGREJ, BASHKIA LEZHË

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik", Udhëzimin Nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit Mjedisit, "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullësor kombëtar", pas shqyrtimit të dokumentacionit, Kryetari i Bashkisë:

PROPOZON:

1. Miratimin e hapjes së rrugës auto dhe dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar për ndërtimin e rrugës auto të lagjes Butem, fshati Ungrej, Njësia Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë, sipas raportit tekniko-ekonomik bashkangjitur. Sipërfaqja që jepet në përdorim për ndërtimin e rrugës detajohet si mëposhtë:
  - **0.034** km rrugë me gjerësi 4m, në ngastrën pyjore **127b**, ekonomia pyjore "Brinjat e Tërtonit".
  - **0.531** km rrugë me gjerësi 4m, në ngastrën pyjore **127c**, ekonomia pyjore "Brinjat e Tërtonit".

2. Sipërfaqja për ndërtimin e rrugës është **0.23 ha**. Për këtë sipërfaqe e cila do të kthehet në rrugë auto, Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjve bën përditësimin kadastral duke pasqyruar vetëm zvogëlimin në volum dhe jo në sipërfaqe.
3. Rehabilitimi i sipërfaqes pyjore prej **0.69 ha** bëhet nga Bashkia Lezhë, në skarpatat e rrugës që do të ndërtohet.
4. Afati për dhënien në përdorim është **1 vit**(përfshirë periudhën e garancisë së punimeve) dhe vlera e qerasë është **39637.5** (Tridhjetë e nëntë mijë e gjatshtëqind e tridhjetë e shtatë pikë pesë) lek.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

**KRYETARI**

**Pjerin NDREU**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE  
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr 7205/prot.

Lezhë, më: 30.5.2025

RELACION

**PËR SHPJEGIMIN E PROCEDURËS TË DHËNIES NË PËRDORIM TË FONDIT  
PYJOR KOMBËTAR, SHOQËRISË T&J CONSTRUCTION SH.P.K PËR  
NDËRTIMIN E RRUGËS AUTO TË LAGJES BUTEM, FSHATI UNGREJ, NJËSIA  
ADMINISTRATIVE UNGREJ, BASHKIA LEZHË**

Ky projekt është një vepër që ndërtohet për nevojat e komunitetit dhe financohet nga Këshilli i Qarkut Lezhë, për të cilët kërkohet të bëhet miratimi i hapjes së rrugës me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Duke qenë se projekti prek sipërfaqe pyjore ndërkohë që prona është e vetë Bashkisë, operatori ndërtues i infrastrukturës, ka paraqitur kërkesë pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve për dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore për ndërtimin e rrugës Butem, Njësia Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë.

Shoqëria **T&J CONSTRUCTION SH.P.K**, e cila është shoqëria e kontraktuar për ndërtimin e kësaj rruge, ka paraqitur kërkesën me numër ekstra prot datë 29.04.2025 pranë Bashkisë Lezhë, për marrjen në përdorim të sipërfaqes pyjore kombëtare për ndërtimin e rrugës auto në lagjen Butem, fshati Ungrej, Njësia Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë.

Bazuar në ligjin 57/2020 datë 30.4.2020 “Për Pyjet”, si dhe në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, kërkesa i drejtohet Këshillit Bashkiak për miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore për ndërtimin e rrugës auto në lagjen Butem, fshati Ungrej, Njësia Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë me një gjatësi **0.565km** që kalon në sipërfaqe pyjore në pronësi të Bashkisë Lezhë.

Në këto raste, sipas VKM-së së sipërcituar nuk bëhet heqje nga fondi pyjor, por për efekt kadastral bëhet vetëm pakësimi në volum i materialit drusor që pritet në trasenë e ndërtimit të rrugës auto. Për sipërfaqen prej **0.23 ha** pyll që dëmtohet si rezultat i ndërtimit të rrugës auto do të bëhet rehabilitimi mjesisor në raportin e tre fishit të sipërfaqes së përdorur, siç e përcakton VKM-ja numër 537 datë 22.09.2022 “Për përcaktimin e kostove të përlllogaritura për pyllëzim kompensues, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor”.

Për këtë rast sipërfaqja që i nënshtrohet rehabilitimit mjedisor do të jetë **0.69 ha**.

Rehabilitimi mjedisor do të kryhet nga Bashkia Lezhë, pasi kjo rrugë ndërtohet për llogari të vetë Bashkisë, në kuadër të përmirësimit dhe ndërtimit të infrastrukturës rrugore rurale

Rruga auto financohet nga Këshilli i Qarkut Lezhë, sipas kërkesës për financim të Bashkisë Lezhë e cila mban numrin e protokollit 13914, datë 19.08.2024. Kjo rrugë do të shërbejë për aksesimin e banorëve të kësaj zone me infrastrukturën ekzistuese, gjithashtu do të mbetet infrastrukturë në shërbim të fondit pyjor të ekonomisë pyjore "Brinjat e Tërtonit".

Në këto kushte, bazuar në ligjin numër 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", ligjin numër 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", VKM-në numër 888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik", bazuar në kërkesën e paraqitur nga subjekti **T&J CONSTRUCTION SH.P.K** për marrje toke pyjore në përdorim, i propozojmë Këshillit Bashkiak të shprehë miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore, për ndërtimin e rrugës auto në lagjen Butem, fshati Ungrej, Njësia Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë me një gjatësi **0.565 km** që kalon në parcelat pyjore **127b** dhe **127c** të ekonomisë pyjore "Brinjat e Tërtonit".

Rruga auto me gjatësi **0.565 km** do të ndërtohet në sipërfaqen pyjore prej **0.23 ha** pyll në pronësi të Bashkisë, sipas raportit tekniko ekonomik bashkangjitur Projekt-Vendimit.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, presim miratimin e projekt-vendimit.

Hartoi relacionin

Ing. Artan PALUSHI

DREJTORI

Paulin GJERGJI

KRYETARI  
Pjerin NDREU

